



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-CC-2023-21

Vendosi: Kryetarja e Dhomave të Specializuara
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

Data: 14 korrik 2023

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Konfidencial

Vendim për Caktimin e Gjykatësve të Panelit të Gjykatës Kushtetuese

Gjykatësve të Panelit të Gjykatës Kushtetuese:

Gjykatës Vidar Stensland

Gjykatës Rumen Nenkov

Gjykatëse Romina Inkuti

Zyrës së Prokurorit të Specializuar

Aleks Uajting

Mbrojtjes së Pjetër Shalës:

Zhan-Lui Zhilisen

Mbrojtësit të Viktimave:

Sajmon Loz

KRYETARJA e Dhomave të Specializuara (“Kryetarja”), duke vepruar në bazë të nenit 33(3) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, (“Ligji”) dhe rregullave 3 dhe 4(2) të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve të Dhomave të Specializuara nga Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë (“Rregullorja për Caktimin e Gjykatësve”), me anë të këtij vendimi cakton një Panel të Gjykatës së Apelit për të marrë vendim mbi Kërkesën Referuese drejtuar Panelit të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me Shkeljen e të Drejtave Themelore të Garantuara nga nenet 31, 32, dhe 54 të Kushtetutës së Kosovës dhe nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (“Kërkesa Referuese”).¹

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 6 dhjetor 2022, Trupi Gjykses nxori Versionin e Korrigjuar të Vendimit në lidhje me Deklaratat e Dhëna më Parë nga Pjetër Shala, (“Vendimi i Kundërshtuar”) në të cilin, ndër të tjera, hedh poshtë kërkesën e z. Pjetër Shala për t’i shpallur deklaratat e tij të mëparshme dhënë Policisë Gjyqësore Federale Belge në 2016 si të papranueshme për procesin gjyqësor aktual.²

2. Më 13 dhjetor 2022, z. Shala kërkoi leje për ta apeluar Vendimin e Kundërshtuar,³ e cila u miratua nga Trupi Gjykses më 24 janar 2023.⁴

¹ KSC-CC-2023-21/F00001, Kërkesë Referuese drejtuar Panelit të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me Shkeljen e të Drejtave Themelore të z. Shala të Garantuara nga nenet 31, 32, dhe 54 të Kushtetutës së Kosovës dhe nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, 11 korrik 2023 (konfidenciale).

² KSC-BC-2020-04/F00364/COR, Version i Korrigjuar i Vendimit në lidhje me Deklaratat e Dhëna më Parë nga Pjetër Shala, 8 dhjetor 2022 (konfidenciale), para. 114. Vendimi original u dorëzua më 6 dhjetor 2022 dhe një version i redaktuar publik u dorëzua më 26 janar 2023.

³ KSC-BC-2020-04/F00369, Kërkesë për Leje për Apelim të Vendimit në lidhje me Deklaratat e Dhëna më Parë nga Pjetër Shala, 13 dhjetor 2022.

⁴ KSC-BC-2020-04/F00401, Vendim mbi Kërkesën për Leje për Apelim të Vendimit në lidhje me Deklaratat e Dhëna më Parë nga Pjetër Shala, 24 janar 2023.

3. Më 13 shkurt 2023, z. Shala e apeloj Vendimin e Kundërshtuar (“Apeli”).⁵
4. Më 5 maj 2023, Paneli i Gjykatës së Apelit e miratoi pjesërisht Apelin, por megjithatë konstatoi se deklaratat e dhëna nga z. Shala në 2016 “nuk janë të papranueshme”.⁶
5. Më 18 maj 2023, z. Shala dorëzoi një kërkesë për rishikimin e Vendimit të Kundërshtuar (“Kërkesa për Rishikim”).⁷
6. Më 23 maj 2023, Trupi Gjykses e hodhi poshtë Kërkesën për Rishikim.⁸
7. Më 11 korrik 2023, z. Shala dorëzoi Kërkesën Referuese.

II. CAKTIMI

8. Në përputhje me nenin 33(3) të Ligjit, me pranimin e referimeve në Dhomën e Specializuar të Gjykatës Kushtetuese (“DHSGJK”), caktohen tre gjyqtarë të DHSGJK-së. Nëse njëri prej këtyre gjyqtarëve nuk është në dispozicion për marrje të detyrës, Kryetari i Dhomave të Specializuara cakton një gjyqtar kushtetues rezervë.
9. Kryetarja konstaton se një nga tre Gjyqtarët e DHSGJK-së nuk është në dispozicion për marrjen e detyrës. Për këtë arsye, Kryetarja do të caktojë Gjyqtarin kushtetues rezervë në përputhje me nenin 33(3) të Ligjit dhe rregullën 4(2) të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve

III. KLASIFIKIM

⁵ KSC-BC-2020-04/IA006/F00004, Apel i Mbrojtjes Kundër Vendimit në lidhje me Deklaratat e Dhëna më Parë nga Pjetër Shala, 13 shkurt 2023.

⁶ KSC-BC-2020-04/IA006/F00007, Vendim mbi Apelin e Shalës Kundër Vendimit në lidhje me Deklaratat e Dhëna më Parë, 5 maj 2023, par. 109.

⁷ KSC-BC-2020-04/F00515, Kërkesë e Mbrojtjes për Rishikim të Vendimit në Lidhje me Deklaratat e Dhëna më Parë nga Pjetër Shala, 18 maj 2023.

⁸ KSC-BC-2020-04/F00520, Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Vendim të Përsheptuar mbi Kërkesën për Rishikim të Vendimit në lidhje me Deklaratat e Dhëna më Parë nga Pjetër Shala, 23 maj 2023, par. 10.

10. Kërkesa Referuese është klasifikuar si konfidenciale dhe për këtë arsye vendimi aktual do të ruajë të njëjtin klasifikim në përputhje me rregullën 82(4) të Rregullores, deri sa të riklasifikohet në kohën e duhur në përputhje me rregullën 3(4) të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve.

PËR ARSYET E LARTPËRMENDURA, NË VIJIM, KRYETARJA ÇAKTON

Gjykatës Vidar Stensland

Gjykatës Rumen Nenkov

Gjykatëse Romina Inkuti

në përbërje të Panelit të Gjykatës Kushtetuese për të vendosur në lidhje me Kërkesën Referuese.

__/nënshkrimi/

**Gjykatëse Ekaterina Trendafilova,
Kryetare e Dhomave të Specializuara**

E premte, 14 korrik 2023
Në Hagë, Holandë